



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

Numri i lëndës: 2022:058166

Datë: 29.07.2024

Numri i dokumentit: 05994101

Ac.nr.8525/2022

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Faton Ademi dhe Besnik Bislimaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.A, nga Komuna e Prizrenit, të cilën me autorizim e përfaqëson S.K, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson avokati B.M, nga Prizreni, për shkak të kompensimit të shujtave ditore, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1010/2022, i datës 11.11.2022 në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 25.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

**REFUZOHEȚ** e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1010/2022, i datës 11.11.2022 VËRTETOHEȚ.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1010/2022 ka vendosur që në pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit A.A nga Komuna e Prizrenit.

Në pikën II (dy) të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, që paditësit A.A, në emër të kompensimit të shujtave ditore për 231 ditë pune për vitin 2021 t'ia paguajë shumën prej 462.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Në pikën III (tre) të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në afat prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykin e goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar, ndërsa aktgjykin e gjiqatës së shkallës së parë ta ndryshojë apo ta prish aktgjykin e ankimuar dhe çështjen t'ia kthej të njëjtës gjiqatë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur pala paditëse, me propozim që të refuzohet ankesa e të paditurës si e pathemeltë dhe të vërtetohet aktgjykikmi i atakuar.

Gjykata e Apelit si gjiqatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 25.03.2022 në gjiqatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit kundër Komunës së Prizrenit-Drejtorisë Komunale të Arsimit, me arsyet sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të te gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykin e atakuar (*pa shqyrtim kryesor të çështjes*) C.nr.1010/2022, i datës 11.11.2022 me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij.

Gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune në SHFMU "Hysen Rexhepi", në Komunën e Prizrenit, ku në vitin 2021 ka pasur 231 ditë pune, ku gjykata të njëjtën e ka vërtetuar sipas vëretimit nr.prot. 48/3 i datës 02.02.2022 e lëshuar nga SHFMU " Hysen Rexhepi", dhe me dispozitat e nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të miratuar me datën 18.04.2017, është paraparë se: "*të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë është 2 euro për të punësuarit që kanë marrëdhëni e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restoranit apo kuzhinës, apo një formë tjeter, nuk ka obligim kompensimin e ushqimit.*" Gjykata vërtetoi se paditësi ka të drejtët në kompensimin e ushqimit lidhur me Marrëveshjen Kolektive të Arsimit, e cila ka hyrë në fuqi më 18.04.2017, dhe sipas kësaj kontrate për cdo ditë pune ka të drejtët e kompensimit prej 2 euro në emër të ushqimit, ku në bazë të kësaj paditësit i takon kompensimi në para në shumë prej 462.00 euro për 231 ditë pune.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “*Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*”.

Andaj, bazuar në dispozitat e Nenit 398 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditëseve është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohen nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika o) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka gjykuar brenda kufijve të kërkesëpadisë së paditësit dhe nuk ka bërë tejkalim të kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, nuk është kontestues fakti se paditësit për periudhën kohore të specifikuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar kanë qenë në vendin e punës. Po ashtu nuk janë kontestuese ditët e pranisë së paditësit në punë, e për të cilën periudhë kohore kërkojnë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit - shujtës.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsy se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve*”. Me paragrafin 2

të këtij nenit, përcaktohet se: "Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes". Me paragrafin 3 të këtij nenit, përcaktohet se: "Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës". Me paragrafin 5 përcaktohet se: "Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...". Me nenin 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021 përcaktohet se: "Të punësuarve, (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, përditë e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, përditë pune, është dy Euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjeter, nuk ka obligim kompensim për ushqim". Me nenin 45 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: "MASh, SBASHK dhe Ministria e Financave, angazhohen bashkërisht përfundim se gjatë punësuarve përkohës së parës përgjegjje ndihmuar komunat, këshillat drejtuese të universiteteve dhe drejtoreve shtëpive të studentëve që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare përzbatimin e dispozitave të nenit 35. paragrafët 5, 7 dhe 11 kur të krijohen mundësitë financiare në buxhetin e Republikës së Kosovës, por jo më vonë se viti 2023".

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditësit në emër të pagesës përkompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit gjatë ditëve të pranisë në punë, përsaq se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: "Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka përdetyrë ta përbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përpunim me përbajtjen e tij".

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke e detyruar të paditurën që paditësit t'iu paguaj në emër të ushqimit përditë e kaluara në punë, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministritë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021 dhe se e njëjta është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar dispozitën e nenit 398 të LPK-së i cili shprehimisht përcakton "Kur gjykata, pasi t'i arrijet përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera përdhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë." Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur ka gjykuar këtë çështje kontestimore pa shqyrtim kryesor të çështjes pasi janë plotësuar kushtet ligjore në rastin konkret.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendorur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr.8525/2022, datë 25.07.2024

Kryetare e kolegjit  
Hidajete Gashi Alaj, d.v.